



VENDIM I ASAMBLESË SË ORTAKËVE I SHOQËRISË “MEDIA 6” SHPK

Sot më datë 31.5.2000 u mbledh në Tiranë, në Rr. Dervish Hima, ADA Tower, kati i dytë, asambleja e jashtëzakonshme e aksionereve të Shoqërisë “Media 6” Sh.A.

“Media 6” Sh.A. është rregjistruar si person juridik me vendim të gjykatës së Rrethit Tiranë me nr. 16941 datë 12 Shkurt 1997. Drejtor i shoqërisë është Z. Aleksandër Frangaj. Kohëzgjatja e veprimtarisë është 40 vjet dhe objekti i veprimtarisë është ajo në fushën e mediave televizive. Shoqëria ka si aksionerë tre persona të cilët zotërojnë aksionet si më poshtë:

- Julien Roche zotëron 4,000 (katërmijë) aksione me një vlerë prej 4,000,000 (katërmilionë) lekë;
- Marsel Skëndaj zotëron 4,000 (katërmijë) aksione me një vlerë prej 4,000,000 (katërmilionë) lekë;
- Aleksandër Frangaj zotëron 4,000 (katërmijë) aksione me një vlerë prej 4,000,000 (katërmilionë) lekë.

Drejtimi e mbledhjes e mori Z. Aleksandër Frangaj i cili konstaton se në mbledhje janë të pranishëm të gjithë aksioneret e shoqërisë dhe e deklaroi mbledhjen të hapur për të diskutuar mbi pikat e rendit të ditës për të cilat aksioneret kanë marre me parë dijeni.

1. Miratim i raportit të ekspertit për rritjen e kapitalit të shoqërisë dhe përcaktimi i kontributit të secilit ortak në këtë kapital;
2. Emetimi i aksioneve të reja, nënshkrimi dhe pagimi i tyre;
3. Ndryshimi i paragrafit të parë të nenit 5 të Statutit të Shoqërisë i cili bën fjalë për kapitalin e shoqërisë;

1. MIRATIM I RAPORTIT TË EKSPERTIT PËR RITJEN E KAPITALIT TË SHOQËRISË NËPËRMJET KONTRIBUTEVE NË NATYRË

Z. Aleksander Frangaj vuri në dijeni ortakët e tjerë se në vijim të mbledhjes së Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionereve datë 25.05.2000 eksperti i caktuar nga aksioneret Z. Ilirjan Hoxha ka përgatitur dhe ka vënë në dispozicion aktin e ekspertimit në të cilin ka përcaktuar vlerën e kapitalit të rritur si dhe kontributin e secilit ortak në këtë kapital. Ky akt u është bërë i njohur aksionereve disa ditë më parë. Z. Frangaj fton aksionistët të diskutojnë dhe shprehin mendimin e tyre në lidhje me raportin e ekspertit dhe vlerën në të cilën do të rritet kapitali.

Pas një diskutimi të hollësishëm, Aksionerët me unanimitet vendosën: Miratimin e raportit të ekspertit për kontributet dhe rritjen e kapitalit nga 12,000,000 lek në 180,000,000 (njëqind e tetëdhjetë milionë) lekë.



3. EMETIMI I AKSIONEVE TË REJA, NËNSHKRIMI DHE PAGIMI I TYRE.

Z. Frangaj i propozoi Asamblesë që rritja e kapitalit të bëhej nëpërmjet emetimit të 168,000 (njëqindgjashtëdhjetëetë mijë) aksioneve të reja me vlerë prej 1,000 lekë secila dhe i ftoi ata të deklaronin dhe nënshkruanin secili numrin aksionve që u takonin të paguara prej tyre .

Pas në diskutimi të hollësishëm ortakët me unanimit vendosën që rritja e kapitalit të bëhej nëpërmjet emetimit të 168,000 (njëqindgjashtëdhjetë mijë) aksioneve të reja me vlerë prej 1,000 lekë secila. Dhe deklaruan se nënshkruanin përkatësisht këto aksione:

- Z. Julien Roche nënshkruan 56,000 (pesëdhjetëegjashtë mijë) aksione me një vlerë prej 56,000,000 (pesëdhjetëegjashtë milionë) lekë;
- Z. Marsel Skënde nënshkruan 56,000 (pesëdhjetëegjashtë mijë) aksione me një vlerë prej 56,000,000 (pesëdhjetëegjashtë milionë) lekë;
- Z. Aleksandër Frangaj nënshkruan 56,000 (tridhjetëegjashtë mijë) aksione me një vlerë prej 56,000,000 (pesëdhjetëegjashtë milionë) lekë.

Aksionet u nënshkruhet dhe u kontribuan në natyrë nga aksioneret

Që nga ky moment struktura e shoqërisë është si më poshtë

- Julien Roche zotëron 60,000 (gjashtëdhjetë mijë) aksione me një vlerë prej 60,000,000 (gjashtëdhjetë milionë) lekë;
- Marsel Skëndaj zotëron 60,000 (gjashtëdhjetë mijë) aksione me një vlerë prej 60,000,000 (gjashtëdhjetë milionë) lekë;
- Aleksandër Frangaj zotëron 60,000 (gjashtëdhjetë mijë) aksione me një vlerë prej 60,000,000 (gjashtëdhjetë milionë) lekë.

3 NDRYSHIMI I PARAGRAFIT TË PARË TË NENIT 5 TE STATUTIT

Aksioneret vendosin në mënyrë unanime ndryshimin e paragrafit të parë të nenit 5 të Statutit si më poshtë vijon:

“5.1. Kapitalit themeltar i Shoqërisë është caktuar 180,000,000 (njëqind e tetëdhjetë milionë) lekë i ndarë në 180,000 (njëqind e tetëdhjetë mijë) aksione nominative dhe të regjistruara me një vlerë nominale prej 1.000 (një mijë) lekë secila. Kapitali i Shoqërisë formohet nga kontributet mëposhtme në para dhe në natyrë të Ortakëve Themelues:

- a. Z. Julien Roche, ka nënshkruar 60,000 (gjashtëdhjetë mijë) aksione, të barabarta me 60,000,000 (gjashtëdhjetë milionë) Lek;*
- b. Z. Marsel Skënde, ka nënshkruar 60,000 (gjashtëdhjetë mijë) aksione, të barabarta me 60,000,000 (gjashtëdhjetë milionë) Lek;*